REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME

Deklaratë për shtyp e Ministres për Evropën dhe Punët e Jashtme, Olta Xhaçka, me Ministrin e Punëve të Jashtme, Bujar Osmani Tiranë, 5.2.2021

2021-02-05 15:23:00

Deklaratë për shtyp e Ministres për Evropën dhe Punët e Jashtme, Olta Xhaçka

Mirëdita të gjithëve!

Unë dua t'i shpreh edhe njëherë mirëseardhjen kolegut tim, Ministrit të Jashtëm të Maqedonisë së Veriut, z. Bujar Osmani.

Siç e dini, kjo është vizita e parë e një Ministri të Jashtëm që nga momenti që mora detyrën dhe jam e lumtur që pata nderin të mirëpres kolegun Osmani. Kjo jo vetëm për faktin që marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut janë vërtet të shkëlqyera, por edhe për faktin që ka diçka speciale kur mund të bisedosh në shqip me një homologun tënd.

Patëm vërtet një bisedë të shkëlqyer dhe konstruktive. Në fakt, temat që ndajmë me Maqedoninë e Veriut janë aq të shumta, sa nuk mjafton një bisedë apo një vizitë si kjo për t'i prekur të tëra. Por jam e sigurt që me z. Osmani do të vazhdojmë atë traditë shumë të suksesshme komunikimi e bashkëpunimi, që është konsoliduar tashmë prej vitesh mes vendeve tona.

Marrëdhëniet e shkëlqyera mes Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut janë realisht një nga shtyllat e stabilitetit, sigurisë dhe zhvillimit në rajonin tonë. Ne ndajmë të njëjtën bindje, që bashkëpunimi dypalësh mund dhe duhet të zgjerohet më tej, qoftë në diplomaci, qoftë në shkëmbime, qoftë në fusha si ndërlidhja midis vendeve tona, infrastruktura, energjia, shkëmbimet tregtare, turizmi, arsimi, kultura etj, sepse nga kjo do të përfitojnë jo vetëm vendet tona, por edhe mbarë rajoni.

Kjo vizitë vjen në një moment të rëndësishëm për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Një moment me shumë sfida e vështirësi, por edhe një moment shprese e guximi për të parë përpara.

Vendet tona po përballen, prej thuajse një viti me pandeminë COVID-19, me pasojat e kësaj pandemie, jo vetëm tek shëndeti i popujve tanë, por edhe tek sistemet shëndetësore dhe ekonomitë tona. Situata me të cilën jemi përballur që prej Marsit 2020, ka qenë vërtet e vështirë për të gjithë ne e për të gjithë botën në fakt. Por pikërisht në kohë si kjo, kemi nevojë më shumë se kurrë për bashkëpunim e solidaritet, sidomos mes vendesh si tonat, që ka aq shumë gjëra që i lidhin.

Por, krahas kësaj krize mbarë botërore që na ka prekur edhe ne, 2021 në fakt është edhe një moment shprese, sepse si Shqipëria, ashtu edhe Maqedonia e Veriut, presin të hedhin një hap të rëndësishëm përpara në procesin e integrimit evropian.

Dhe dua të përfitoj nga ky rast, për të theksuar edhe njëherë disa fakte, për të cilat besoj që kam edhe dakordësinë e kolegut Osmani.

Së pari, të dyja vendet tona, siç e ka konfirmuar edhe vetë Këshilli në Mars 2020, i kanë plotësuar kushtet për mbajtjen e Konferencës së parë Ndërqeveritare. Dhe të dyja vendet tona kanë bërë shumë punë për të plotësuar kushtet. Në këtë pikë, dua në fakt të vlerësoj maksimalisht vendosmërinë dhe punën e Kryeministrit Zaev, të qeverisë së tij, të koalicionit qeverisës dhe të faktorit shqiptar, për të çuar përpara integrimin evropian të Maqedonisë së Veriut.

Gjithkush që e njeh rajonin tonë, besoj e kupton që arsyeja përse qoftë në Shqipëri, qoftë në Maqedoninë e Veriut, ka qenë e mundur që të hidhen hapa kaq të guximshme përpara, është sepse ne – pjesa dërrmuese e popullsive tona – besojmë tek perspektiva

evropiane. Do të ishte për të ardhur keq, në qoftë se kjo punë kaq e madhe e ky besim kaq i madh do të zhgënjeheshin sërish, për shkak të konsideratave subjektive, politike të vendeve anëtare, në një moment që vlerësimi objektiv, teknik nga ana e Këshillit dhe vendimi i tij në mars 2020 ka qenë pozitiv.
Së dyti, stabiliteti, siguria dhe zhvillimi i rajonit tonë janë të lidhura në mënyrë të pazgjidhshme me perspektivën evropiane. Anëtarësimi i Maqedonisë së Veriut në NATO ishte një arritje e shkëlqyer, që e ka bërë rajonin tonë shumë më të sigurt. Anëtarësimi në BE i mbarë rajonit, është garancia e zhvillimit të rajonit, por jo vetëm kaq, është edhe një kontribut i madh për sigurinë e vetë BE.
Dhe këtu – e lashë për në fund sepse dua t'i jap peshën që i takon dhe vlerësimin tim maksimal – ka luajtur e luan një rol të jashtëzakonshëm faktori shqiptar në Maqedoninë e Veriut, që jo vetëm ka dhënë e jep një kontribut jetik në qeverisjen e vendit, jo vetëm ka luajtur një rol vendimtar në proceset euroatlantike, por është në fakt edhe një urë e fortë lidhëse, miqësie e bashkëpunimi mes Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut.
Shqipëria e ka mbështetur dhe do të vazhdojë ta mbështesë fuqimisht faktorin shqiptar në Maqedoninë e Veriut, angazhimin konstruktiv të partive politike shqiptare, por edhe progresin e mëtejshëm në çështje me rëndësi themelore, siç është nevoja për zbatimin praktik të MKO-së e Ligjit të Gjuhëve, si gurthemeli i arritjes së barazisë së plotë mes popullit maqedonas dhe atij shqiptar, si dy komunitete shtetformuese.
Unë nuk po zgjatem më tej, por dua ta falënderoj kolegun Osmani, t'i uroj atij shumë suksese në punën e tij, ta garantoj për dëshirën time dhe të qeverisë shqiptare për të forcuar edhe më shumë marrëdhëniet mes vendeve tona dhe pa humbur kohë t'i kaloj fjalën.

Deklaratë për shtyp e Ministrit të Punëve të Jashtme, Bujar Osmani
Faleminderit shume?!
Te? nderuar te? pranishëm! E dashur Olta!
Me? lejoni te? filloj fillimisht duke falënderuar kolegen time Olta Xhac?ka, vërtetë me? paraqet nder te? jem sot këtu disa dite? pas marrjes se? detyrës nga ana juaj, është vizita ime e pare? ne? Shqipëri si Ministër i Jashtëm, dhe një mundësi e mire? qe? publikisht dhe personalisht fillimisht ta përgëzoj kolegen Xhac?ka për besimin qe? i është dhëne? dhe ti uroj sukses ne? menaxhimin e sfidave ne? këtë? detyre? te? përgjegjshme.
Ne te? dy jemi udhëheqës te? rinj te? diplomacive te? vendeve tona dhe besoj se kemi bashkëpunim dhe konstatuam sot gatishmëri për bashkëpunim te? hapur, për mbështetje te? ndërsjellë, për te? arrire? te? gjitha qëllimet qe? janë me interes te? përbashkët te? dy vendeve tona. I tille? është bashkëpunimi ynë brenda aleancës euro-atlantike. Dëshiroj t'ju kujtoj se kemi pasur mbështetje te? sinqerte?, te? thelle? dhe te? qarte? nga Republika e Shqipërisë gjatë periudhës se? anëtarësimit tone? ne? NATO; për c?ka sot i shpreha mirënjohje te? veçantë koleges sime. Sot si anëtarë te? NATO-s, si aspirim i te? dy vendeve vazhdon te? jete? edhe anëtarësimi i plote? ne? Bashkimin Evropian, një proces për te? cilin jemi dakord se nuk ka alternative?.
Është e padiskutueshme qe? marrëdhëniet midis dy vendeve tona, prej kohësh e kane? kaluar pragun e fqinjësisë se? mire? dhe ata janë baze? e themeleve te? miqësisë stabile dhe afatgjate?. Besoj se kjo miqësi e jona është përtej interesave vetëm te? dy vendeve tona dhe është një ndër shtyllat me? te? rëndësishme për stabilitetin, sigurinë dhe prosperitetin e gjithë rajonit. Qëllimet dhe interesat për zhvillimin e bashkëpunimit rajonal janë te? dy anshme. Jemi te? vendosur ne? përpjekjet për përforcimin e tij dhe secili prej nesh jep kontribut ne? zhvillimin e fqinjësisë? se? mire? midis te? gjitha vendeve te? Ballkanit Perëndimor.
Si fqinj te? afërt jemi drejtpërdrejt te? interesuar për suksesin e dialogut Prishtine?-Beograd te? udhëhequr nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara te? Amerikës, i cili ne? një mase? te? madhe do te? frymëzojë një force? te? re, një impuls te? ri te? besimit ne? rajon dhe do te? hape? një hap serioz për një Ballkan me? te? sigurt dhe te? qëndrueshëm. Kontributi ynë? ne? bashkëpunimin rajonal është i sinqerte?, pa marre? parasysh nëse flitet për brenda procesit te? Berlinit, apo bashkëpunim ne? kuadër te? ashtuquajturit Mini-Shengen, apo te? ndonjë iniciative tjetër te? bashkëpunimit rajonal. Ne? këtë drejtim pata nderin qe? t'ia prezantoj ministres nismën e re për bashkëpunim trepalësh qe? buron nga vendi ynë, e ashtu-quajtura iniciativa 8.
Është një iniciative? e mire? qe? duhet te? rinovoje? mbështetjen

politike, për projektet e infrastrukturës përgjatë korridorit 8 evropian, duke lidhur kështu Lindjen me Perëndimin e Ballkanit nga Adriatiku ne? Detin e Zi. Te? tre vendet, Maqedonia e Veriut, Shqipëria dhe Bullgaria ne? këtë iniciative? mund te? gjejnë një forum te? vlefshëm për promovimin e bashkëpunimit trepalësh, duke intensifikuar shkëmbimin e përgjithshëm politik, ekonomik, te? sigurisë, atë kulturor dhe shoqëror qe? sigurisht do te? rezultojë ne? përforcim te? besimit mes qytetarëve tanë.

Teme? e diskutimit ishte edhe projekti ynë i ri, —Forumi i Prespës për Dialog— si një platforme? e ardhshme për promovimin e mundësive dhe përfitimeve nga dialogu, promovimin e procesit te? pajtimit, promovimin e multi-kulturalizmit ne? rajon, si një sfide? e rëndësishme për te? gjitha vendet e Ballkanit, por gjithashtu një platforme? për kontributin tone? te? përbashkët ne? multilateralizmin, si një përfitim i vërtetë civilizues dhe i politikës bashkëkohore.

Me? lejoni te? shpreh kënaqësinë time te? veçantë qe? sot do te? nënshkruajmë edhe marrëveshjen për bashkëpunim ne? fushën e diasporës, një sukses i dy qeverive për c?ka dua te? shpreh mirënjohjen time ne? këtë drejtim. Ne? kuadër te? bashkëpunimit dypalësh, u përsërit interesi për mbajtjen e mbledhjes se? dyte? te? përbashkët qeveritare, qe? do te? jete? një mundësi për nënshkrimin e marrëveshjeve te? reja bilaterale dhe pasurimin e mëtejshëm te? përbashkët.

Ramë dakord se do te? intensifikojmë bashkëpunimin ne? te? gjitha nivelet, ne? mënyrë qe? te? sigurojmë stimuj shtese? për zbatimin e projekteve ne? infrastrukture?, energji, turizëm dhe fusha te? tjera te? rëndësishme për shtetasit tanë. I tille? është bashkëpunimi ne? fushën e kulturës për c?ka ne? takimin e sotëm shprehëm kënaqësinë e ndërsjellë për hapjen e qendrës Kulturore dhe Informative te? Maqedonisë se? Veriut ne? Tirane?, e cila do të kontribuoje? ne? njohjen me? te? afërt te? qytetarëve ne? fushën e kulturës.

Te? gjitha këto konstatime flasin me? vete se kjo vizite? është jashtëzakonisht e suksesshme, për c?ka me? lejoni edhe një here? ne? fund te? falenderoj kolegen time Olta Xhac?ka. Faleminderit shume?!